



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025, faza e dytë.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, duke u bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Udhëzimin nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 23 datë 8.7.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

- 1 Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2023-2025, faza e dytë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
- 2 Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
- 3 Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi